

## Termet e Referencës

### Ekspert/Lehtësues për Trajnim

<b>Organizata</b>	HANDIKOS(Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
<b>Projekti:</b>	Shërbimet e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara janë Fuqizuar dhe të Qëndrueshme
<b>Zbatohet nga:</b>	HANDIKOS
<b>Mbështetur nga:</b>	UNICEF
<b>Qëllimi i Angazhimit</b>	Trajnimi për njohjen e Konventës për të drejtat e fëmijëve
<b>Vendi</b>	Prishtinë, Kosovë
<b>Data e publikimit</b>	14 Gusht 2023
<b>Data e pritjes së angazhimit</b>	30 Gusht 2023
<b>Kontakti</b>	<a href="mailto:handikos@handi-kos.org">handikos@handi-kos.org</a>

### 1. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të projektit “Shërbimet e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi (RBB) për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara janë Fuqizuar dhe të Qëndrueshme”, i cili zbatohet nga HANDIKOS dhe mbështetet nga UNICEF në partneritet me USAID Kosova, ka për qëllim që të promovojë mbrojtjen e fëmijëve dhe përmirësimin e qeverisjes së të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë.

### 2. OBJEKTIVA E DETYRES

Qëllimi i përgjithshëm i ekspertit do të jetë zhvillimi i përmbajtjes së programit të trajnimit dhe ofrimi i trajnimit mbi “**njohjen e Konventës për të drejtat e fëmijëve**” – Grupi “Hëna”, gjatë muajit Korrik të vitit 2023.

### 3. FUSHEVEPRIMI

Zhvillimi i programit të trajnimit dhe mbajtja e trajnimit për Grupin e fëmijëve dhe të rinjve “Hëna”:

- Informimin dhe aftësimin e anëtarëve të grupit “Hëna” për njohjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara karshi Konventës për të drejtat e fëmijëve.
- Programi i Trajnimit do të drejtohet nga eksperti në koordinim të ngushtë me ekipin e projektit të HANDIKOS dhe koordinatorin e grupit “Hëna”.

#### **Eksperti do të jetë përgjegjës për ndërmarrjen e detyrave vijuese:**

- Zhvillimi i programit dhe metodologjisë trajnuese 1-ditore për Trajnimin lidhur me “**njohjen e Konventës për të drejtat e fëmijëve**” me fokus për natyrën e punëve të OJQ-ve dhe të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.
- Lehtëson dhe mbanë trajnimin siç është rënë dakord me ekipin e projektit të HANDIKOS dhe partnerët e projektit.
- Të bashkëpunojë me ekipin e Projektit për të vendosur objektivin, metodologjinë dhe përmbajtjen.
- Përgatit materialet /prezantimet/ në përputhje me moshën e pjesëmarrësve.
- Përgatit raportin e trajnimit në gjuhën shqipe.

#### **4. METODAT DHE MJETET**

Metodat e mëposhtme mund të përdoren për të përfunduar detyrat e përmendura më lart dhe për të përmbushur qëllimin siç përcaktohet nga kjo ToR.

1. Takime konsultative me HANDIKOS dhe ekipin e Projektit;
2. Trajnim (1 ditë) për Modulin “**njohjen e Konventës për të drejtat e fëmijëve**” për përfaqësuesit e fëmijëve nga grupi “Hëna”;
3. Dokumente (punë përgatitore);
4. Prezantimi;

#### **5. SHKATHTESITE, PERVOJA DHE KUALIFIKIMET PER EKSPERTIN**

Kandidati duhet të posedojë këto aftësi dhe kompetenca:

- Të paktën të jetë i/e diplomuar në shkenca juridike, shkenca sociale ose fusha të ngjashme;
- Përvojë e gjerë në organizimin / mbajtjen e trajnimeve në fushën e avokimit për nevoja të OJQ;
- Njohuri të Konventës në fjalë dhe të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Demonstron përvojë të mëparshme për detyra të ngjashme;
- Aftësi të mira komunikimi me fëmijët dhe të rinjtë;
- Komunikimi i shkëlqyeshëm në të folur dhe shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze;
- Ndërgjegjësimi kulturor dhe ndjeshmëria ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar;

#### **6. KOHEZGJATJA E DETYRES**

Kohëzgjatja e detyrës planifikohet të jetë jo më shumë se 1 ditë trajnimi dhe të përfundojë gjatë periudhës Korrik 2023 (bazuar në marrëveshje të ndërsjellë).

#### **7. MATERIALI PER DETYREN**

Eksperti do të punojë ngushtë me ekipin e projektit të HANDIKOS. Të gjitha materialet do t'i dorëzohen ekipit të Projektit të HANDIKOS në datën siç është rënë dakord reciprokisht gjatë takimit fillestar. Raportet

do të rishikohen nga HANDIKOS dhe partnerët e Projektit. Të gjitha projekt-dokumentet do të dorëzohen në forma elektronike ndërsa produktet përfundimtare do të dorëzohen në formë elektronike dhe kopjet e shtypura.

#### **Eksperti duhet të paraqesë materialet kryesore të mëposhtme:**

- Agjenda e trajnimit;
- Përmbajtja e programit në përputhje me moshën e anëtarëve të grupit “Hëna”(pjesëmarrësve prej moshës 11-18 vjeç);
- Prezantimi PowerPoint ose llojet e tjera të mjeteve që përdoren për qëllimin e trajnimit;
- Doracakë / manuale ose material tjetër për pjesëmarrësit;
- Raporti i vlerësimit të trajnimit nga këndvështrimi i ekspertit;

#### **8. BUXHETI PER TRAJNIM**

Buxheti për trajnimin është planifikuar të jetë 150,00 Euro në ditë.

Projekti do të mbulojë koston financiare për vendin, ushqimin dhe freskimin, materialet dhe logjistikën e tjera të kërkuara të trajnimit.

Pagesa do të bëhet pas dorëzimit të Raportit të Trajnimit! Departamenti i Financave do të zvogëlojë kontributet tatimore dhe pensionale bazuar në legjislacionin tatimor të Kosovës.

#### **9. DATAT TENTATIVE DHE VENDI**

Datat tentative: 30 Gusht 2023 (bazuar në marrëveshje reciproke)

Vendi: Qendra e Resurseve e HANDIKOS, Veternik, Prishtinë

#### **10. PROCEDURA PER APLIKIM**

Eksperti /kompania e interesuar duhet të paraqesë dokumentet e përmendura më poshtë deri në orën 17:00, të datës 21 Gusht 2023.

- Një CV e përditësuar (Maksimumi 3 faqe)
- Një letër aplikacioni dhe informacione kontakti.
- Koncepti i trajnimit

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për Trajnimin **“Konventa për të drejtat e fëmijëve”**.

Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në adresën: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org)  
cc: [gresa.stublla@handi-kos.org](mailto:gresa.stublla@handi-kos.org)

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen.